

FLUIDING M

Plastifikues betoni dhe ngadalësues i ngjitjes (ngurtësimit), i përpunuar në bazë polikarboksilati

Në përputhje me: EN 934-2: T10

FUSHA E APLIKIMIT

Përgatitja e betoneve ekonomike me raport optimal ndërmjet komponentëve dhe performancës së betonit;
Përgatitja e përzierjeve "standarde" të betonit të destinuara për kryerjen e pozicioneve të ndryshme në objektet e ndërtimit (themele dhe struktura të tjera nëntokësore, dysHEME industriale, shtylla AB, trarë, struktura meskatëshe, struktura rrugore betoni, struktura hidroteknike, mure mbajtëse, etj.)

Përgatitje e përzierjeve të betonit të destinuar për transport dhe që hidhen me pompë;

Betonim i elementeve të ndërtimit me seksione të përforcuara dendur me armaturë;

Betonim në kushte të temperaturave të larta të ambientit;

Betonim i seksioneve masive të betonit, ku ekziston rreziku i pasojave të padëshiruara të shkaktuara nga proceset ekzotermike në beton;

Përgatitje e përzierjeve injektuese të çimentos;

CILËSITË

- Mundëson reduktimin e ujit deri në 15%;
- Mundëson transport të prolonguar dhe hedhje të betonit (deri në 90 minuta);
- Përmirëson punueshmërinë e betonit pa shtim të ujit;
- Lehtëson hedhjen e betonit në kushte të temperaturave të larta të ambientit;
- Rrit kompaktësinë dhe hidroizolimin e betonit;
- Përmirëson karakteristikat fiziko-mekanike të betonit (rritje e karakteristikave të fortësisë fillestare dhe përfundimtare);

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE


CILËSI	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Pamja	-	Lëng ngjyrë kafe
Masa e volumenit (ha 20°C)	ISO 758	(1.05±0.02) g/cm ³
Përmbajtja e klorureve	EN 480-10	≤0,1%
Përmbajtja e alkaleve	EN 480-12	≤4,5%
pH-vlera (ha 20°C)	ISO 4316	4,0±1,0

DOZIMI DHE PERFORMANSAT:


Doza optimale e Fluiding M-së varion nga 0,3 në 1,0% në lidhje me sasinë e çimentos në përzierjen e betonit. Me këtë dozë arrihet një reduktim i ujit deri në 15% (Diagrami 1). Në të njëjtën kohë, në përputhje me rrethanat arrihet një rritje në karakteristikat përfundimtare të fortësisë së betonit (Diagrami 2).

Doza optimale e Fluiding M-së përcaktohet më së miri me provat paraprake laboratorike ose industriale.

Për betonin referencë, sipas EN 480 – 1 duke përdorur CEM I 52.5 N



Diagrami 1: Reduktimi i ujit



Diagrami 2: Rritja e fortësisë me Fluiding M

Në kushtet e temperaturave të larta të ambientit, ose në rastin kur prodhimi, transporti dhe futja e betonit në ndërtim zgjat më shumë se 90 minuta, rekomandojmë që të dozohet në mënyrë plotësuese një aditiv për të ngadalësuar ngurtësimin e betonit, Ngadalësues D2..

Dozimi i aditivëve bëhet me dorë ose automatikisht gjatë prodhimit të betonit. Efekti më i mirë arrihet kur Fluiding M shtohet së bashku me 20-30% të fundit të ujit të nevojshëm në beton, në masën paraprakisht të përzier nga agregati, çimentoja dhe 80% të ujit në beton. Rekomandohet që kohëzgjatja e përzierjes së betonit të freskët me shtimin e Fluiding M-së të mos jetë më e shkurtër se 90 sekonda.

Efektet e mbidozimit: Një dozë shumë e lartë e Fluiding M-së mund të shkaktojë ndarje dhe ngurtësim të vonuar të betonit.

KOMPATIBILITETI

Fluiding M është kompatibel me disa aditivë nga programi ADING i grupit të përsheptuesve dhe ngadalësuesve, aditivë për betonim në dimër, aditivë për hidroizolim, aerantë, etj. Nëse në përzierjen e betonit përdoren dy ose më shumë aditivë, është e nevojshme të kryhen teste paraprake. Aditivët e ndryshëm dozohen veçmas, pra nuk përzihen me njëri-tjetrin përpara se të hidhen në përzierjen e betonit. Fluiding M është i përdorshëm me të gjitha llojet e çimentos Portland duke përfshirë çimento rezistente ndaj sulfatëve.

PAKETIMI

Kanta plastike: 20 kg
Fuçi: 200 kg
Kontejnerë: 1000 kg

RUAJTJA NË DEPO

Në paketimin origjinal në një temperaturë prej 5°C deri në 35°C. Afati i përdorimit: 12 muaj

Fq. 2 nga 3

ADING

ADING AD, Shkup – Novoselski pat (rr. 1409) nr.11,1060 Shkup, R. e Maqedonisë së Veriut;
Tel.: +389/02 2034 840; Fax: + 389/02 2034 850; e-mail: ading@ading.com.mk; www.ading.com.mk



www.ading.com.mk

SHENJA E SERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT

 2032	
ADING AD Shkup	
Novoselski pat (rruga 1409) nr. 11, 1060 Shkup, Maqedoni 08	
GAAB001/6	
EN 934-2:2009+A1:2012	
FLUIDING M	
Aditiv për beton, plastifikues/ngadalësues	
EN 934-2:T10	
Përmbajtja e joneve të klorit	≤ 0,1% sipas masës
Përmbajtja të alkaleve	≤ 4,5% sipas masës
Veprimi koroziv	Përmban komponentë EN 934-1:2008, Aneks A.1

Rreziku për shëndetin: Fluiding M nuk përmban substanca toksike, por duhet pasur kujdes për të parandaluar kontaktin e materialit me lëkurën, sytë ose të mos gëlltitet. Në rast kontakti me lëkurën ose sytë, është e nevojshme të shpëlahet menjëherë me ujë të pastër të rrjedhshëm. Nëse gëlltitet, kërkoni kujdes mjekësor. Informacion shtesë jepet në Fletën Sigurisë së produktit.

Zjarri: Fluiding M është një lëng jo i ndezshëm. Informacion shtesë jepet në Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Produktit.

Pastrimi dhe deponimi: Mbetjet e shpërndara të Fluiding M-së pastrohen me ujë. Paketimi i vjetër i përdorur duhet të hidhet sipas rregulloreve lokale për atë lloj mbetjeje. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.

Fq. 3 nga 3

ADING

ADING AD, Shkup – Novoselski pat (rr. 1409) nr.11,1060 Shkup, R. e Maqedonisë së Veriut;
Tel.: +389/02 2034 840; Fax: + 389/02 2034 850; e-mail: ading@ading.com.mk; www.ading.com.mk



www.ading.com.mk

ADITIVË PËR BETON DHE ÇIMENTO